



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Data/Datum/Date:	20.07/2026
Nr./Br./No	02/880
Për/Za/To:	Muhadin Halili, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Përmes/Preko/Through:	Zyrës së Kryetarit
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës për <i>Qemajl Aliu</i>
Lënda/Predmet/Subject :	Aprovim

Sipas Nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe neni 9.1 germa k, e Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit:

Furnizim me pelet për institucionet e Komunës së Shtimes

1. Visar Tershani
2. Idriz Mehmeti
3. Mursel Salihu

Kryesues
anëtar
anëtar

1. Anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë siç janë specifikuar për anëtarët e stafit të Prokurimit në Nenin 23.3 të LPP-së, dhe do të nënshkruajnë deklaratën me shkrim.
2. Anëtarët e komisionit i nënshtrohen dispozitave të Nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.
3. Secili anëtar do të nënshkruaj Deklaratën nën Betim duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP "Deklaratën nën Betim" që deklaron që ai/ajo do të kryej detyrën e vlerësimit në përgjegjësi të plotë dhe në pajtim me LPP.

4. Komisioni do të funksionoi nga dita e miratimit të vendimit për krijimin e komisionit deri në permbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara nga autoritetit kontraktues, me shkrim, ose deri në vendimin për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

5. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas pranimi të këtij vendimi.

6. Komisioni do të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 dite nga hapja e ofertave.

7. Komisioni do të marrë vendimet e tij në takime me votë të thjeshtë të shumicës, me votim të hapur. Procesi i votimit do të regjistrohet në procesverbal.

8. Komisioni, në fund të detyrës së tij, do të përgatit një rekomandim për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklaratë të arsyeve mbështetëse për rekomandimin.

9. Vendimi përfundimtarë për dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës për Prokurim. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit ose të refuzoj atë. Nëse rekomandimi i komisionit refuzohet, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do të shpjegojë me shkrim arsyet. Shpjegimi i tillë do të përfshihet në të dhënat e procedurës së aktivitetit të prokurimit. Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues do të informohet menjëherë për refuzim të tillë.

10. Në rast se një anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se ai / ajo ka një konflikt interesi në verësimin e tenderit, ai / ajo duhet të deklarojë interesin e tij / saj në tender dhe të lëshojë takim dhe nuk do të marrin pjesë më tej në procesin e vlerësimit. Individit, i cili nuk merr pjesë më në vlerësim, konsiderohet edhe më tutje si i betuar për konfidencialitet.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë së Prokurimit.